

**AKT-THEMELIMI**  
**LSHOOERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"END SHOES"sh.p.k.**

Ortaku i Shoqerise "**END SHOES**"sh.p.k. Z.Saimir Pistoja, i birl i Bujer dhe Caje, i lindur ne date 07.07.1974, me nr personal identifikimi H40707009B, nihadhor dhe me zotesi te plete per te vepruar,

Sot, me date 27/01/2024

**VENDOSI**

**Neni 1**

Te themeloj nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar te quajtur: "**END SHOES**"sh.p.k. Shoqeria eshte nje subjekt juridik, te ciles i lind e drejta te ushtroje aktivitetin qe nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit.

Shoqeria "**END SHOES**"sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj.

**Neni 2**

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive Tregtare me Pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se derdhur ne kapitalin themeltar.

**Neni 3**

"**END SHOES**"sh.p.k. e ka seline ne adresen: Durres, Durres, Shkozet, Lagja 14, Rruga "Aurora", ndertese private, 2 kateshe, zona kadastrale nr.8518, me nr pasurie 17/245/ND, Shqiperi.

Shoqeria ka te drejte te krijoj brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesimi, seli sekondare, dege, si dhe t'i suprimoje ato.

Shoqeria ka gjithashtu te drejte te krijoje, apo te jete pjese e nje apo me shume shoqerive tregtare, pavaresisht nga statusi i tyre juridik, me nje pjesemarrje qe do te percaktohet ne cdo rast me Vendim Ortaku.

**Neni 4**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete paafat. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe ne perputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin ne fuqi.



### Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqerise "END SHOES" sh.p.k. do te jetë 100.000 (njeqind mijë) lek, i perbere nga kuote e vetme, që perben 100% të kapitalit.

### Neni 6

Kapitali themeltar është ne para dhe ne natyre. Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë teresish të derdhura dhe të nenshkuara nga ortaku themelues. Rritja e kapitalit të shoqerise nuk është e kufizuar.

### Neni 7

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqerise do te jetë:

Import eksport tregeti i artikujve të ndryshem të te gjitha llojeve me shumice dhe pakice, qepje faqe kepuce, prodhim i konfektioneve të ndryshme si dhe tregtimi i tyre brenda dhe jashtë vendit me shumice dhe pakice. Tregtimi i artikujve të ndryshem, ushqimore, bujqësore, blegtore, industriale, materiale ndertimi, e hidro-sanitare, pjese kembimi e makineri te çdo lloji, pajisje teknologjike. Servis pajisjesh elektronike dhe elektro shtepiake, automjetesh etj. Fotokopjim, perkthim. Punime duralumini e tregtimi i tyre. Punime druri e tregtimi i tyre. Transport të mallrave e të udhetareve urban, nderurban dhe internacionale. Perpunimin aktiv me mall porositesi

Per realizimin e qellimit te mesiperme shoqeria ka të drejte:

- Tju besoj te treteve pjese te punimeve te produkteve te saj ose sherbimeve;
- te perfundoje kontrata agjensie me ose pa perfaqesim, me qellim qe te promovoje per llogari te pales tjeter ose te promovohet nga pala tjeter per llogari te saj, aktivitetet dhe prodhimet e mesiperme, duke perfshire te gjitha aktivitetet e ndermjetesimit te cfaredo fushe;
- te operoje si ne territorin kombtar dhe jashtë tij.

Shoqeria mundet gjithashtu te realizoje te gjitha operacionet industriale, tregtare, mobiliare, imobiliare dhe financiare qe do te konsiderohen nga ortaket apo nga organi Administrativ te nevojshme ose te dobishme per arritjen e objektivit te shoqerise, perfshire ketu leshimin e fidejusioneve dhe garancive te tjera reale ose personale si ne favor dhe per llogari te te treteve edhe me titull te garantuar. Shoqeria mund te bleje lirisht kuota apo aksionete shoqerive te tjera, vendase dhe te huaja.

### Neni 8

Shoqeria vepron nen regjirnin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufiritte kapitalit te saj. Ortaku themelues mbart rrezikun e veprimtarise se Shoqerise ne masen e kapitalit te investuar ne Shoqeri.



### Neni 9

Organet e shoqerise "END SHOES"sh.p.k. jane:

- Ortaku i Vetem i Shoqerise
- Administratori i shoqerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutin e shoqerise.

Administrator i shoqerise do te jetë Z. **Saimir Pistolja**, i identifikuar me ID nr H40707009B, i cilid te ushtroje dhe mbaje ne menyre te vecante kompetencat e administratorit, per nje periudhe prej 5 (pesë) vjetesh. Ky afat mund te ndryshoje lirisht ne cdo moment qe konsiderohet e nevojshme nga asambleja e ortakeve.

Pervec sa eshte percaktuar shprehimi i statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise, vetem administratori do te kete tagra te kryeje veprime bankare ne llogarine e shoqerise qe lidhen me terheqjen e shuma vete depozitura apo cdo veprim tjeter, veprime te cilat mund te kryhen vetem nga administratori apo persona te tjere te autorizuar enkas me prokure te posacme per kete qellim.

Modalitetet per ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i Shoqerise, ligji 9901 date 14.04.2008 "PerTregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007" Per Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Ky Akt -Themelimi eshte perpiluar ne kater kopje me vlore te njejte me originalin.

**ORTAKU I VETEM ISHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"END SHOES"sh.p.k.**

**Z. SAIMIR PISTOLJA**

